

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
RAPORTI TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS PER AKTIVITETIN:
"GRUMBULLIM, TRANSPORTIM,
RUAJTJE DHE RICIKLIM I MBETJEVE
PLASTIKE"**

”

Vendodhja : Zona Industriale, Fier.

Kërkues: Subjekti: "BAHITI PLAST" Sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANagements CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

| PERMBAJTJE: | FAQE |
|---|-------------------------------------|
| 1. PERSHKRIM I PROJEKTIT | 2 |
| 1.1. Nje pershkrim i shkurter i projektit te propozuar | 2 |
| 1.2. Qellimi i projektit | 2 |
| 1.3. Informacion mbi vendodhjen e projektit. | Error! Bookmark not defined. |
| 1.4. Nevojat per riciklim te mbetjeve plastike ne Shqiperi | 3 |
| 1.5. Subjekti kerkues | 4 |
| 1.6. Pershkrimi i teknologjise se aplikuar | 4 |
| 1.7. Analiza SWOT: Avantazhet — Dobesite — Oportunitetet —Rrisqet e veprimtarise se riciklimit te mbetjeve plastike. | 8 |
| 2. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE KRYESORE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TIJ | 10 |
| 2.1. Hyrje | 10 |
| 2.2. Permbledhje e ndikimeve te fazes operationale dhe masat zbutese te propozuara | 11 |
| 3. PROGRAMI I MONITORIMIT PER PROJEKT ZHVILLIMIN | 17 |
| 3.1. Plani i Monitorimit Social e Mjedisor gjate funksionimit te aktivitetit | 17 |
| 3.2. Analiza e alternativave | 18 |
| 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME | 20 |
| 4.1. Konkluzione | 20 |
| 4.2. Rekomandime per investitorin | 20 |

1. PERSHKRIM I PROJEKTIT

1.1. Nje pershkrim i shkurter i projektit te propozuar

Projekti për realizimin e një impianti për riciklimin e mbetjeve plastike të llojeve të ndryshme.

Projekti i propozuar është një aktivitet në fushën e grumbullimit, transportimit, ruajtjes dhe riciklimit të mbetjeve plastike të llojeve të ndryshme si Plastmas PVC, LD, plastike HDPE, etj. të cilat mund të gjenerohen nga produkte të ndryshme të dalta jashtë përdorimi si ambalazhe produktesh industriale e ushqimore, shishe plastike të produkteve industriale e ushqimore, plastmasi bujqësor dhe në përgjithësi ai i tipit fletor, për përdorime të ndryshme, produkte dhe përberje plastike të paisjeve të ndryshme me përberje të tilla.

Qëllimi i këtij impianti është përpunimi dhe riciklimi i mbetjeve plastike nga gjendja fillestare e grumbullimit e cila mund të përmbaje papastërti të shumta deri tek prodhimi i produktit të granuluar që mund të përdoret si lende e pare për prodhim të produkteve të tjera plastike. Ky aktivitet do të zhvillohet në Zonën Industriale, Fshati Zhupan, Njesia Administrative Qender, Bashkia Fier, Qarku Fier. në zonën industriale. Objekti në të cilin do të instalohet impianti është ekzistues dhe është kryer një ndarje e ambienteve të tij në funksion të aktivitetit. Sipërfaqja në dispozicion të këtij aktiviteti, sipas kontratës së qerases është $S = 2242.5\text{m}^2$ dhe e objektit $S = 654\text{m}^2$. Aktiviteti synon objektiva afatmesem dhe afatgjatë të funksionimit të tij, duke kontribuar ndjeshëm në reduktimin e mbetjeve plastike në vend dhe duke krijuar një mjedis më të pastër.

Vlen të theksohet se mbetjet plastike janë ndër mbetjet më jetetgjatesine me të madhe në mjedis dhe nga ndotesit me problematike në mjedisin Shqiptar, ndotje kjo e verejtur në mjedisin urban, mjedisin ujor të lumenjve dhe grykederdhjeve të tyre, si dhe në disa raste të djegies së tyre ndotes potencial të ajrit dhe shkaktar të semundjeve të ndryshme. Reduktimi dhe menaxhimi në mënyrë të integruar i këtyre mbetjeve.

1.2. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij impianti është përpunimi dhe riciklimi i mbetjeve plastike nga gjendja fillestare e grumbullimit të tyre, të cilat mund të përmbajnë papastërti të shumta deri tek prodhimi i produktit të granuluar që mund të përdoret si lende e pare për prodhim të produkteve të tjera plastike. Në raste të caktuara duke përdorur elemente shtese mund të prodhohet edhe produkt i cilesise së pare.

1.3. Nevojat per riciklim te mbetjeve plastike ne Shqiperi

Nje nga ndotesit me kontribut te konsiderueshem ne mjedis ne rang boteror jane mbetjet e ngurta urbane. Nder perbersit kryesore te ketyre mbetjeve jane objektet me perberje plastike. Kjo per faktin se ambalazhimi i produkteve ushqimore, por edhe atyre industriale eshte me baze plastike dhe kartoni. Rritja e standartit dhe e kerkesave per kushte higjenike te produkteve ushqimore por edhe atyre farmaceutike ka cuar ne njeperdorimin e ambalazhit duke mos aplikuar rimbushjen e ketyre produkteve. Keshtu sasia e shisheve plastike te produkteve ushqimore te cilat perbejne pjesen me te madhe te mbetjeve plastike eshte rritur ndjeshem. Po keshtu, per shkak edhe te kostos se lire te prodhimit dhe riciklimit te ketyre produkteve ato perdoren vetem nje here dhe me pas hidhen, duke perfshire ketu edhe nje sere ambalazhesh industriale, te lodrave plastike, te eneve plastike si kovat e bojës, apo fuci te lendeve te ndryshme, shishe dhe fuci te ambalazhimit te vajrave lubrifikante, te solucioneve te ndryshme, etj.

Mbetjet plastike ne vendin tone jane nje sfide e madhe per organet e mbrojtjes se mjedisit, pasi ato nder vite jane hedhur ne mjedis dhe jane perhapur ne te gjithë vendin, te ndihmuara edhe nga kushtet klimaterike. Mungesa e nje kulture dhe infrastrukture ne fushen e grumbullimit te mbetjeve urbane, seleksionimin e tyre qe ne vendburim, mungesa e landfilleve te mirefillta per menaxhimin e tyre per zona te ndryshme te vendit, mungesa e nje teknologjie dhe infrastrukture per menaxhimin dhe riciklimin e tyre duke iu rritur vleren nepermjet blerjes se tyre, si dhe mos kontrollimi i subjekteve pergjegjese per grumbullimin e tyre ka shkaktuar nje gjendje te nje mjedisi teper te ndotur ne kete drejtim. Keto lloj mbetjesh shkaktojne edhe nje ndotje vizive ne permasa te medha, duke u ndikuar edhe nga faktoret klimaterike, duke ndikuar per keq edhe ne zhvillimine turizmit dhe si rrjedhoje edhe zhvillimin ekonomiko-social te vendit. Me tej djegia e mbetjeve plastike ose atyre te gomes, nga persona te pa identifikuar ose nga nje teknologji e tille qe te prodhoje energji prej tyre, do te shkaktonte nje ndotje serioze te cilesise se ajrit dhe te shendetit publik.

Aktivitetet te grumbullimit, transportimit, ruajtjes dhe riciklimit ose asgjesimit ne menyre te integruar ose teknologjike te paster per mjedisin duhet te mbeshteten financiarisht dhe te kene procedura te thjeshtuara nga organet shteterore, duke nxitur keshtu efektin e pastrimit te mjedisit dhe te uljes se kostos se perdorimit te ketyre produkteve te riciklueshme.

1.4. Subjekti kerkues

Subjekti "BAHITI PLAST" Sh.p.k, eshte nje subjekt privat i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit(QKR) me Numer Identifikimi (NIPT): K58002601Q dhe ka perfaqesues ligjor Z. Musa Bahiti.

Objekti i aktivitetit te ketij subjekti sipas regjistrimit ne QKR eshte:

Projektim dhe zbatim te punimeve te gjitha llojeve te ndertimit ne godina banimi, civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqerore, etj.

Punime dheu, sistemime, tarracime. Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, punime per prishjen e ndertimeve. Rruge,autostrada, mbikalime, hekurudhe, punime ne shina, traversa, diga dhe tunele hidroteknik, punime nentokesore, ura e vepra arti. Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij, puse shpimi per uje, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikimi.Ndertim impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane, grumbullimin e perpunimin e mbetjeve plastike te lendeve te ndryshme te perpunuara e te paperpunuara.Nxjerrjen dhe perpunimin e inerteve lumore, inerteve te gurit e copetimit te tyre, prodhimin e betoneve dhe llaceve per ndertim, prodhimin e konstruksioneve me beton, dru, metal etj. Ndertim i impianteve per prodhimin e energjise elektrike shperndarjen e saj. Tregtim me shumice e pakice te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, tekstile, industriale, elektroshtepiake, produkteve ushqimore etj, import-eksport i tyre. Tregtim me pakice karburante, vajra lubrifikante, pjese kembimi, import i tyre, hapje pike servisi per te gjitha llojet e automjeteve si dhe shitblerje automjete, vetura. Import dhe eksport i lendeve te para, makineri e linja prodhimi. Transport mallrash te gjitha llojeve, brenda dhe jashte vendit. Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, fshatrave turistike, baresh, restorantesh, qendra pushime e dekorative etj, si dhe agjensi per shitblerje, dhenie me qera te pasurive te tundeshme e te patundeshme, agjencie komisionere etj. Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Shfrytezim mineralesh,eksport i tyre.Permirsim dhe shfrytezim te pyjeve,perpunim dhe tregtim te lendes drusore,mobilieri,orendi shtepiake,dyer,dritare import-ekport i tyre.Punime duralumini,hapja e lokaleve per kete qellim etj.

Objekti ne vleresim i subjektit eshte instalimi dhe funksionimi i nje impianti per perpunimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike te llojeve te ndryshme si Plastmasi, HDPE, etj.

1.5. Pershkrimi i teknologjise se aplikuar

Në këtë dokument jepet shkurtimisht përshkrimi teknologjik i linjës së riciklimit. Dokumenti është I shoqëruar me skemën teknike të projektit.

Proçesi fillon me seleksionimin manual të materialeve plastike që realizohen në makinerinë nr. 001 në skemën teknologjike. Nëpërmjet shiritit rrëshqitës transportohen materiale jo vetëm si lëndë e parë por edhe të përpunuara. Në këtë njësi do të ketë puntorë të cilët do të bëjnë seleksionimin e materialeve pasi është e pamundur ti ndash ato në mënyrë automatike. Më pas materialet e seleksionuara me anë të një shiriti transportues rrëshqitës me gjerësi 1200 mm (makineria nr . 2 në skemën teknologjike)

transportohen drejt grirësit të njëanshëm (makineria nr . 3 në skemën teknologjike). Kjo makineri përdor një rrotullues të përbërë nga hekuri me presa të shumta si presa fikse dhe rrotulluese ku copëtohen materialet. Gjithashtu, makineria ka një dhomë shkarkimi ku prodhon copa me përmasa të përlogaritura ose riqarkullon materialet e llogaritur në dhomën ushqyese. Mateiali copëzohet në pjesëza me dimensione deri në 100 mm. Këto pjesëza nëpërmjet nyjes së grirësit me diametër 300mm (makineria nr . 4 në skemën teknologjike), transportohen në makinerinë e para -lavazhit (makineria nr. 5 në skemën teknologjike) . Kjo makineri është e programuar posaçërisht me një rrotullues të përbërë nga katër rrathë të bashkangjitur për të pranuar material të madhësive të ndryshme pa e prekur njëri tjetrin. Në thelb makineria me proces të kombinuar midis ujit dhe forcës së fërkimit për të larguar shumicën e ndotësve sipërfaqësorë dhe të pranojë gurë, copa të vogla çeliku dhe materiale të tjera të forta. Me anë të njëjës transportuese (makineria nr . 6 në skemën teknologjike) materialet transferohen në vaskën e lundrimit (makineria nr . 7 në skemën teknologjike) .

Rezervuari dekantimit i ndan materialet në bazë të peshës së tyre specifike. Në këtë proces materialet me densitet më të madh se uji si p.sh. alumini, çeliku, gurë dhe materiale të tjera dekantojnë kështu që materiali granulator është i mbrojtur dhe nuk mund të dëmtohet. Materialet pluskues depozitohen në fund të rezervuarit përmes një fluksi uji që krijohet nga dy shtylla të fiksuara me paleta të përshtatshme.

Materiali pluskues rrjedh në fund të vaskës falë një nyjeje horizontale që e dërgon një nyje tjetër rrëshqitëse në ngarkim të makinerisë pasardhëse. Nje vaskë tjetër shërbimi kontrollon fluksin sipërfaqësor dhe atë të vaskës kryesore. Kjo makineri është e pajisur dhe me një sistem tharës, me lidhje hidraulike dhe natyralisht është e ndërtuar me parametra shumë rezistentë. Materialet që fundosen nxirren vazhdimisht me anë të një krëhëri horizontal me transportues të fiksuar me vidë, i cili duhet të jetë gjithmonë në gjendje pune për të pastruar. Mbas këtij procesi materiali i plastikës duket shumë i pastër edhe pse në të ka ende ndotje.

Kështu që mulliri (makineria nr . 8 në skemën teknologjike) merr plastikën që është pjesërisht e larë pa pjesë të forta në mënyrë që të mbrojë jetëgjatësinë e presave. Kjo pajisje ka presa të gjata rrotulluese me 5 presa për linjë dhe dy kundërpresa

mikrorregulluese si dhe shtylla ndihmuese për të garantuar një qëndresë fikse të presave dhe një rrotullim uniform e kostant.

Për më tepër ,makineria punon e ndihmuar nga uji, I cili I kombinuar me forcën e fërkimit të shkaktuar nga rrotullimi i shpejtë i presave, krijon një efekt shumë të mirë pastrimi.

Sita e materialit granulor ka vrima 20 mm për të situar materiale me madhësi 10-20 mm.

Uji dhe materiali I situar grumbullohen nga një pompë e veçantë me relike te hapur që ka disa efekte me shumë larjeje dhe që përcjell çdo gjë në vaskën e lundrimit (makineria nr . 9 në skemën teknologjike) për ndarjen e materialeve LD / HDPE që fundosen, të mbetura në rrjedhë.

Rezervuari dekantimit është i pajisur me sisteme nyjesh në krye për të rritur shpejtësinë e largimit të materialit që depozitohet në fund të vaskës përmes fluksit të ujit të krijuar nga një pompë dhe me një sistem si ujëvarë, shkon në një nyje të formuar për të dërguar në makinerinë tjetër. Një nyje horizontale dhe një tjetër nxjerrin jashtë materialin që tenton të fundoset. Ashtu si në rezervuaret e parë të dekantimit, edhe këtu bëhet nxjerrja e materialeve në dy kontenierë. Një vaskë tjetër më e vogël kontrollon fluksin sipërfaqësor dhe atë të vaskës kryesore. Rezervuari i dytë i dekantimit përmirëson ndarjen me materialet që fundosen si p.sh. film PVC , film alumini dhe materiale të tjera si këto.

Kështu pra, materialet e dekantuar në sasi të caktuara shkojnë tek makineria e lavazhit (makineria nr . 10 në skemën teknologjike) dhe pastaj përmes një nyje transportuese (makineria nr . 11 në skemën teknologjike) për në centrifugën horizontale (makineria nr.12 në skemën teknologjike). Kjo makineri , përveç tharjes, ka një efekt të madh larës sepse rotori bën xhiro në 2.500 RPM duke krijuar një forcë fërkimi shumë të madhe.

Këto janë materialet përfundimtare të thata të centrifugës dhe përmbajtja e lagështisë do të varioje nga 8 në 18%, në varësi të trashësisë.


Materialet e plastikës shkojnë pastaj në një sistem tharës me ajër të ngrohtë (makineria nr . 13 në skemën teknologjike) për të reduktuar nivelin lagështisë nën 6 %, në mënyrë që të futen tek mulliri i dytë (makineria nr . 14 në skemën teknologjike) , dhe pastaj një ekstruder (makineria nr . 15 në skemën teknologjike) . Ekstruderi ka 2 degëzime, filtër me ndërrim dhe prerje tek koka.

Së fundmi, materiali cohet tek stacioni I mbushjes së thasëve (makineria nr . 16 në skemën teknologjike).

Në këtë linjë, uji trajtohet dhe filtrohet në grilat vibruese (makineria nr . 17 në skemën teknologjike), si dhe në filtra të veçantë (makineria nr . 18 në skemën teknologjike) .

Të gjitha makinat janë të lidhura me Panelin e Kontrollit ose elektrik në të cilin janë pozicionuar të gjitha kontaktet, kontrollet e niveleve dhe dipositivëve të sigurimit (makineria nr . 19 në skemën teknologjike). Nga kjo njësi bëhet Start dhe Stop automatik I linjës së procesit me kontrolle automatike të të gjithë parametrave dhe të cfarëdolloj lidhje. Gjithashtu, paneli kontrollit krijon të dhëna për të ardhur në ndihmë në situata alarmesh të emergjencës dhe sitata të caktuara funksionale të procesit.

Skema teknologjike e impiantit



1.6. Analiza SWOT: Avantazhet — Dobesite — Oportunitetet —Rrisqet e veprimtarise se riciklimit te mbetjeve plastike.

➤ Avantazhet

Ndertimi dhe funksionimi i ketij aktiviteti mund të konsiderohet si nje opsion shume i mire per vendin tone, me qellim qe të zhvillohet ndjeshem aktiviteti i grumbullimit te mbetjeve urbane ne menyre te seleksionuar, por mbi te gjitha pastrimi i vendit nga mbetjet urbane te ngurta. Ky opsion ofron nje numer mjaft të madh aspektesh pozitive:

- Efekte ekstra pozitive ne fushen e mjedisit, duke ndikuar ndjeshem ne pastrimin dhe permiresimin e kushteve mjedisore.
- Potencial per zhvillimin e turizmit dhe gjendjes ekonomike-sociale te vendit nga te ardhurat e turizimit.. Vendi yne ka zona shume atraktive, te pa prekura nga ndertimet, te pa ndotura dhe me nje peizazh te mrekullueshem.
- Potencial zhvillimi ekonomik si rrjedhoje e punesimit ne grumbullim, transportim ruajtje dhe perpunim ose riciklim te ketyre mbetjeve.
- Rritje e punesimit dhe vetepunesimit ne sektore te ndryshem.
- Ulja e kosos se prodhimit te produkteve plastike dhe te plastmasit nga lenda e pare e ricikluar.
- Prezantimi dhe aplikimi i nje teknologjie bashkekohore dhe eficiente ne vendin tone. Kjo nepermjet nje investimi relativisht te larte.
- Pozicionimi i tij ne nje zone te miratur per zhvillimin e industrise, energjitikes dhe tregtise.
- Afersia e tij me zonen industriale dhe energjitike dhe menaxhimi i mbetjeve dhe shkarkimeve nga impianti i trajtimit te shkarkimeve te zones industriale.

➤ Dobesite:

Disa nga dobesite e ketij projekti mund te jene si me poshte:

- Tregu ne Shqiperi mund te mos plotesoje kapacitetet e ketij aktiviteti, duke nenkuptuar mosfunksionimin e tij me kapacitet dhe staf te plote. Kjo duke qene se importi i mbetjeve eshte i ndaluar.
- Deri ne ndertimin e plote te infrastruktures se zones industriale dhe energjitike, do te nevojiten investime per sigurimin e infrastruktures inxhinierike
- Rritja e kosos se perpunimit per shkak te mos ndarjes qe ne vendburim te mbetjeve.

➤ Oportunitetet:

Prodhimi i lendes se pare per produkte plastike dhe te qeseve te plastmasit, ofrone nje numer të madh oportunitetesh per Shqiperine dhe investitoret shqiptare.

Disa nga keto oportunitete jane:

- Mundesia e riciklimit dhe riperdorimit te mbetjeve plastike, duke reduktuar mbetjet dhe lenden e pare te paster.
- Ofrojne nje numer të madh oportunitetesh per Shqiperine dhe investitoret shqiptare ne sektorin e prodhimit te produkteve plastike dhe te plastmasit filter.
- Ofrimi i produkteve cilesore, te lendes se pare me nje cmim te konkurueshem ne tregun vendas dhe te huaj.
- Rritje e numrit te punesareve dhe vetepunesareve per grumbullimin, transportimin, seleksionimin dhe perpunimin e mbetjeve, etj.

➤ Rrisqet:

Ka disa rrisqe te cilat mund tu shkaktojne probleme operatoreve private ne vendin tone, gje qe mund të vonoje dhe pengoje vijimesine e procesit te riciklimit per shkak te teknologjise jo cilesore e cila nuk kryen keto procese qe kryen ky impiant.

Ne raste te avarive ose te pakujdesise, renia e zjarrit mund te shkaktoje nje dem te madh mjedisor dhe shendetesor ne kete zone, nga djegia e produkteve plastike te cilat jane plotesisht te djegshme dhe te demshme per mjedisin.

2. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE KRYESORE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TIJ

2.1. Hyrje

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

2.2. Permbledhje e ndikimeve te fazes operationale dhe masat zbutese te propozuara

| Cilesia e ajrit | | | |
|--|---|--|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Clirimi i gazeve te demshem per mjedisin | Emetimi i gazeve te demshem nga gjeneratori ne raste te mungeses se energjise elektrike. Procesi teknologjik nuk perfshine procese me djegie. | Cilesia e ajrit lokal do te jete brenda parametrave te BE-se nuk vleresohet ndikim domethenes, oret e punes mund te jene te pakta dhe vetem ne raste emergjence. | Perdorimi i impiantit ne oret me energji elektrike nga rrjeti. Kolaudimi i gjeneratorit dhe paisja me depozite te katalitike. |
| Perhapja e ererave te pa kendshme nga materialet e papastra. | Magazinimi i produktit ne shesh te hapur dhe i ekspozuar nga kushtet klimaterike. | I perkohshem, jo shqetesues per banoret. | Depozitim i perkohshem dhe ne sasi jo te larte. Ndertimi i nje kapanoni per sheshin e depozitimit. |
| Ndotja e ajrit nga djegia e mbetjeve plastike ne raste te renies se zjarrit. | Lenda e depozituar per perpunim, ose produkti perfundimtar i magazinuar. Shkalla e ndotjes e larte. | Efekt negativ i larte, shkarkim i gazeve te demshem per shendetin. | Masa te rrepta sigurie dhe zbatimi i kushteve teknike gjate punes. Ndertimi i nje sistemi eficient per mbrojtjen nga zjarri, trajnimi i punonjesve per perdorimin e tij. |

| Ujerat siperfaqesore dhe toka | | | |
|--|---|---|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekt i mjedis | Masat parandaluese |
| Ndotje e ujrave siperfaqesore nga sistemi i kanalizimeve te zones. | Ambjenti i punes, brenda kantierit te mbuluar, te shtrohet me beton dhe te krijohet rrjeti kanalizimeve kulluese. | Ne rast se do te zbatohen rekomandimet e permendura ne raportin e VNM, nuk do te kete ndikim ne mjedisin e zones. | Te orientohen ujerat per ne vaskat e dekantimit pasi mund te kete shpelarje te materialit te depozituar. |
| Ulja e cilesise se ujrave siperfaqesore si pasoje e derdhjes se ujrave industriale | Nuk ka shkarkime industriale ne mjedisin ujqor te zones, eshte cikël i mbyllur. | Nuk vleresohet efekt i mbetur. | Nuk ka rekomandim. perdorur. |
| Ndotja e ujrave siperfaqesore si pasoje e shkarkimit te ujrave te zeza te demshme / te paperpunuara. | Ujerat qe do te prodhohen nga objekti do te jene ne nivele teper te uleta dhe nuk vleresohen me ndikim ne mjedis. | Ndikim shume i ulet, nuk vleresohet ne nivele shqetesuese | Shkarkimi ne sistemin e zones. |
| Erozioni i tokes | Ne kete siperfaqe nuk ekziston | Nuk ka | Nuk ka |
| Ndotja e tokes dhe ujrave tokesore | Nga ujerat e shplarjes se materialit te lendes se pare. | Nese orientohen ujerat nuk ka ndikim, siperfaqet do te jene te betonuara ne sheshin e depozitimit. | Betonim i siperfaqeve te depozitimit, orientimi i ujrave ne vasken e dekantimit. |

| Perdorimi i materialeve dhe menaxhimi i mbetjeve | | | |
|---|--|---|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Ruajtja/magazinimi i mbetjeve te ngurta plastike sipas standartit dhe kushteve te sigurise. | Nga renia e zjarrit aksidental dhe nga shpelarja e materialit te depozituar. | Ndikim domethenes ne mjedis nese ndodh nje avari e tille. | Masa te rrepta sigurie dhe zbatimi i kushteve teknike gjate punes. Ndertimi i nje sistemi eficient per mbrojtjen nga zjarri, trajnimi i punonjesve per perdorimin e tij. |
| Manaxhimi i mbetjeve | Ndotje vizuale dhe e ujerave te shiut ne rast te magazinimit tej normes. | Ndikim ne peizazhin e zones dhe te ujerave te sistemit te kanalizimeve te objektit. | Lidhja e kontratave me subjektet e licensuar me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti. Asgjesimi i mbetjeve ne kohe dhe mos grumbullim mbi kapacitetet magazinuese. |

| Ekologjia | | | |
|---|---|---|---------------------------|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Depozitimi i ndotjes(emisioneve) ne mjedisin natyror perreth qe con ne dobesimin e prodhimitarise se bimesise dhe demtimin shendetit. | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka |
| Ulja e prodhimitarise dhe shqetesim i gjallesave nga zhurmat | Nuk ka efekti vetem brenda mjediseseve te kapanonit | Nuk vleresohet te kete ndikim ne mjedis | Nuk ka |

| Ndikimi peisazhor dhe vizual | | | |
|--|--|---|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Demtim i karakterit peisazhor dhe bukurise pamore per shkak te depozitimit te mbetjeve mbi kapacitete dhe ne shesh te hapur. | Depozitimi mbi kapacitete dhe ne shesh te hapur. | Efekt i dukshem dhe shqetesues per banoret prane zones. | Shmangia e magazinimit mbi kapacitete dhe ndertimi i nje kapanoni per te reduktuar kete efekt. |

| Trafiku dhe transporti | | | |
|--|--|---|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Rritja e trafikut te mjeteve te renda ne trafikun tokesor, por ne nivele te uleta. | Ndotje e mjedisit nga trafiku ne zone. Jo ne nivele te larta, infrastruktura eshte ekzistuese. | Trafiku nga ky aktivitet ka potencialin per te kontribuar ne shtimin e trafikut rrugor por jo ne nivele shqetesuese | Perdorimi i infrastruktures ekzistuese |

| Zhurma dhe vibrimi | | | |
|---|---|--|--|
| Ndikimi mjedisor | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndotjes | Efekti ne mjedis | Masat parandaluese |
| Zhurma nga veprimataria | Puna e impiantit, vetem ne ambjentin e punes, jo ne ambjentet e jashteme te objektit. | Ndikim ne shendetin e punonjesve | Perdorimi i mjeteve mbrojtese per shqisat e degjimit, vizita te shpeshta tek mjeku perkates. |
| Zhurme nga shtimi i trafikut ne rrjetin rrugor lokal. | Automjetet e transportimit te mbetjeve dhe produktit. Ne nivele jo shqetesuese. | Demtimi I segmenteve rrugore nga automjetet e renda te ketij aktiviteti dhe te zones industrial ne pergjithesi. Ngritja e pluhurave dhe clirimi i gazeve nga qarkullimi i mjeteve. | Perdorimi i infrastruktures ekzistuese, perdorimi i mjeteve te kolauduara, qarkullimi ne orare me trafik me pak te renduar, reduktimi i renies se borieve ne zona te banuara, etj. |

| Ndikime sociale | | | |
|--|---|--|------------------------------|
| Ndikimi social-ekonomik | Burimi i shkarkimit dhe shkalla e ndikimit | Efektet ne mjedis | Masat parandaluese |
| Rritja e punesimit (ndryshim pozitiv) | Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal | Efekt shume pozitiv per tregun vendas te punes dhe te produktit. | Ndikim pozitiv, nuk ka masa. |
| Rritja e takses se biznesit dhe te ardhurave te njesise se qeverisjes vendore (ndryshim pozitiv) | Aktiviteti i subjektit dhe rritja e punesimit ne zone. | Rritja e te ardhurave te njesise vendore dhe e individeve te punesuar. | Ndikim pozitiv mesatar |
| Shendetet dhe cilesia e jetes se punonjesve. | Nga rritja e te ardhurave, rritje e mireqenies dhe cilesise se jetes. | Efekt pozitiv ne permiresimin ekonomik te vendit dhe te nje pjese te punetoreve. | Ndikim pozitiv i ulet |
| Zone e trashegimise dhe kultures | Nuk ka ndikim, nuk jane identifikuar monumente te kultures. | Nuk ka ndikim te mbetur ne mjediset kulturore. | Nuk vleresohet ndikim. |

3. PROGRAMI I MONITORIMIT PER PROJEKT ZHVILLIMIN

3.1. Plani i Monitorimit Social e Mjedisor gjate funksionimit te aktivitetit

| Ceshtja | Masat | Pergjegjesia | Periudha |
|---------------------------------------|---|---|---|
| Cilesia e ajrit | Inspektime vizuale te zonave te ruajtjes, grumbullimit dhe largimit te mbeturinave. Regjistrimet te behen ne baze te inspektimeve dhe nese shihet e nevojshme te kryhet edhe matja e LNP. | Investitori | Inspektime nje here ne tre muaj. Marrja e masave parandaluese, nese eshte e nevojshme. |
| Zhurmat | Inspektim te zones se impiantit, zhurmat e elektromotereve dhe te presave te produktit. Matja e zhurmave per nivelin e tyre ne lidhje me normat sipas udhezimit Nr.8, date 27.11.2007 Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara. Punonjesit te perdorin kufje per reduktimin e zhurmes. | Investitori | Inspektime nje here ne tre muaj. Marrja e masave parandaluese, nese eshte e nevojshme |
| Mbetjet e ngurta | Analize te mases se ngurte te gjeneruar nga vaska e dekantimit. Mbetjet e gureve dhe te llumrave te menaxhohen ne landfillin e zones. | Investitori | Inspektime tremujore. |
| Ujerat e perdorur | Duke qene cikël i mbyllur dhe nuk ka shkarkime te uejrave te ndotur, ate here nuk rekomandohet analize e ujerave te perdorur. Ne rast te ndotjes se ujerave nga vajra ose solucione te tjera, kjo do te pasqyrohet tek mbetjet e ngurta te vaskes se dekantimit. | Investitori | Nuk rekomandohet, pasi nuk ka shkarkime te ujerave te perdorur. |
| Cilesia e jetes gjate orarit te punes | Matja e nivelit te zhurmes ne kapacitet te plote pune, vizita te shpeshta tek mjeku per punonjesit ne mjedise me zhurma. Te perdoren masa mbrojtese. | Doktori pergjegjes i qendres shendetesore | Cdo 6 muaj |

3.2. Analiza e alternativave

Diskutimi dhe analizimi i alternativave ne Raportin e VNM-se duhet te merren ne konsiderate opsione te tjera te aplikueshme, te cilat mund te ndikojne ne eliminimin e efekteve negative te identifikuar ne mjedis. Kjo procedure ndihmon ne analizimin dhe gjykimin e minimizimit te efekteve ne mjedis dhe shendet.

Alternativat e meposhtme u vleresuan dhe u diskutuan si kuptim i minimizimit te efekteve ne mjedis. Me poshte jepen tre alternativat ne shqyrtim:

1. "Jo-Veprimi".
2. Projekti i paraqitur ne kete raport.
3. Projekti i paraqitur ne kete raport me vendodhje ne nje zone tjeter.

1. "Jo-Veprimi"

Kjo alternative eshte e kerkuar per te vleresuar mjedisin natyror, ne gjendjen e tanishme, pa implemetim te ketij projekti. Kjo pike eshte e nevojshme per nxjerrje perfundimi duke i marre ne konsiderate te gjitha mundesite e zhvillimit te kesaj alternative, ku do te kete nje efekt te moderuar ne mjedis.

Kjo alternative perjashton efektin ne mjedis nga nje aktivitet i ri, por per nje rast specifik dhe jo per ndikimet ne kompleks ose ne teresi. Kjo alternative kryen nje vleresim pa bere kompromis me nevojen e zones apo te rajonit per kete lloj aktiviteti te ri. Kjo alternative "Jo-Veprimi" ka impakt negative ne lidhje me impaktin ekonomiko-social dhe ndikon ne uljen e ndikimit pozitiv mbi ekonomine lokale.

Zhvillimi i ketij aktiviteti eshte i domosdoshem ne vendin tone pasi mungesa e nje sherbimi te tille per riciklimin e mbetjeve plastike dhe prodhimin e lendes se pare per prodhim te produkteve plastike, qe aktualisht importohet rrit koston e lendes se pare dhe te produktit perfundimtar. Ky aktivitet ka nje efekt te konsiderueshem pozitiv ne aspektin mjedisor dhe social-ekonomik. Ndikon duke pastruar mjedisin dhe duke rritur punesimin dhe vetepunesimin, gjithashtu ndikon ne uljen e cmimit te lendes se pare per produktet plastike.

Ne perfundim mund te themi se kjo alternative nuk eshte me interes shume-palesh per tu marre ne konsiderate.

2. Projekti i paraqitur ne kete raport

Impakti dhe masat parandaluese jane te parashikuara ne menyre te permbledhur. Nje prej impakteve kryesore te identifikuar si pozitive eshte ndikimi social- ekonomik dhe mjedisor per kete zone dhe me gjere. Kjo alternative e dhene eshte ne perputhje te plote me nevojat e vendit dhe me nismat e organeve te mbrojtjes se mjedisit per nje mjedis me te paster. Per kete qellim dhe per nevojat qe ka vendi per teknologji te tilla, ky aktivitet eshte vleresuar si i domosdoshem pavaresisht kostove te realizimit te tij.

Ne kostot e realizimit te ketij aktiviteti perfshihen edhe ato mjedisore, megjithese eshte nje aktivitet me ndikim te moderuar ne mjedis, pasi nuk perfshin procese te shkarkimit te ujerave te ndotur. Ky aktivitet ne vetvete sherben ne reduktimin e mbetjeve plastike dhe te ndotjes se mjedisit nga keto te fundit.

Perzgjedhja e kesaj zone per kete aktivitet eshte kryer ne perputhje me vete zhvillimin e zones si zone industriale dhe energjitike te miratuar nga strukturat perkatese. Perzgjedhja e ketij pozicioni eshte kryer duke vleresuar disa faktore te rendesishem te pozicionimit te kesaj zone.

Ne aspektin mjedisor, kjo zone eshte me e pershtatshme pasi ndodhet ne nje zone te paisur me studime te miratuara, nuk ka ne afersi zona te mbrojtura te rendesise se vecante ekologjike dhe kulturore, nuk demton zhvillimin e turizmit, nuk ka nevojte per infrastrukture te re.

3. Projekti i paraqitur me vendodhje tjeter

Nuk jane analizuar zona te tjera per vete karakterin e projektit, kjo lidhet ngushte me qellimin e zones dhe pozicionin strategjik qe ajo ka ne lidhje me portet e vendit, infrastruktures dhe zones industriale.

Ndryshimi i vendodhjes per kete projekt-ide, do te sillte ndikim me te madh ne mjedis, mos funksionimin ne menyre optimale te tij, ndertim te infrastruktures se re, kosto me e larte per zbatimin e tij, etj.

- **Perfundime te analizes se alternatives**

Mbeshtetur sa me siper, alternativa e dyte eshte efciente per kete projekt zhvillimi Ndikimi i ketij projekti ne mjedis sjelle disa efekte te lokalizuara, te cilat nese menaxhohet sipas rekomandimeve ne kete raport nuk do te jene problem per mjedisin e zones.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

4.1. Konkluzione

Projekti i propozuar, synon te ofroje ne tregun vendas nje sherbim te domosdoshem nga ana mjedisore dhe ekonomike, ndikon ndjeshem ne uljen e ndotjes se mjedisit dhe rritjen e punesimit.

Teknologjia qe propozohet te aplikohet eshte bashkekohore dhe kjo do te realizohet ne bashkepunim me nje nga firmat me prestigjoze ne kete fushe dhe me eksperience shumevjecare ne shtetin fqinj, Itali.

Zhvillimi i ketij aktiviteti ne nje zone me studim te miratuar si zone industriale dhe energjitike, afer portit me te rendesishem ne vend dhe rajon, dhe me infrastrukture ne afersi te zones, nese zbaton kushtet mjedisore qe percakton kuadri ligjor, rekomandimet e ketij raporti dhe leja mjedisore nuk do te ndikojne ne nivele shqetesuese ne mjedisin e zones dhe perben nje aspekt pozitiv ne vendimarrje per miratimin e ketij aktiviteti.

4.2. Rekomandime per investitorin

- I. Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta te gjeneruara nga vaskat e dekantimit
- II. Grumbullimi dhe menaxhimi ne menyre te integruar I mbetjeve plastike si lende e pare.
- III. Te shihet mundesia e seleksionimit te mbetjeve qe ne vend-burim, duke shmangur ndotjen e mbetjeve si lende e pare.
- IV. Subjekti pas paisjes me leje mjedisore, duhet te aplikojne prane QKL-se per tu paisur me Licensen e kategorise III.2.B per ushtrimin e aktivitetit.
- V. Rekomandohet shtrimi dhe betonimi i ambjenteve te punes per sheshin perreth objektit, ku mund te depozitohet lenda e pare, si dhe ndertimi i sistemit te kanalizimeve per orientimin e ujerave te shiut ose lendeve te tjera qe mund te gjenerohen gjate procesit te punes.
- VI. Te mos hidhet asnje mbetje e ngurte ose e lenget ne mjedisin ujqor dhe ate tokesor te zones.
- VII. Te zbatohet me rigorozitet projekti I mbrojtjes nga zjarri ne object, duke I kushtuar nje rendesi te vecante, jo vetem ndertimit te sistemit, por edhe per zbatimin e kushteve teknike ne ambjentin e punes.
- VIII. Te kryhet monitorimi i treguesve mjedisor per te shmangur mbi kalim te normave te shkarkimit per kete veprimtari dhe raporti periodik i vetemonitorimit dhe te dorezohet ne ARM e rrethit perkates sipas kerkesave te kuadrit ligjor dhe kushteve te lejes mjedisore.
- IX. Mirembajta dhe gjelberimi ne menyre te vazhdueshem te mjediseve perreth aktivitet duke krijuar nje imazh te kendshem te ambjentit.
- X. Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij.

- XI. Subjekti te zbatohet kushtet qe do te vendosen ne Lejen Mjedisore nga Agjencia Kombetare e Mjedisit.

ANEKS

I. FOTO TE AMBJENTIT DHE INSTALIMEVE

| Pamje e jashtme e kapanonit | Filtrimi paraprak i ujit te perdorur |
|---|--|
|  |  |
| Furnizimi i impiantit me lende te pare | Pamje e nje pjese te impiantit |
|  |  |
| Lenda e pare | Vaske dekantimi |

